



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. \_\_\_ /2026

Dt. 10 / 03 /2026

## PROCESVERBAL

Mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Në Komunën e Deçanit u mbajt mbledhja e parë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin në vijim, e kryesuar nga Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj.

Në mbledhje morën pjesë Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Izet Zenuni, Koordinatorja e KKSB-së, znj. Gentiana Iberhysaj-Mazrekaj, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe anëtarë të tjerë të këshillit.

Pas hapjes së mbledhjes, Kryetari i Komunës informoi të pranishmit lidhur me gjendjen e sigurisë në komunë, duke vlerësuar se ajo vazhdon të jetë e qetë dhe stabile. Ai theksoi se gjatë kësaj periudhe institucionet komunale janë të angazhuara në organizimin e aktiviteteve për shënimin e 24 Marsit, si dhe në organizimin e garës së skijimit, e cila do të mbahet më 15 mars dhe paraqet një aktivitet me rëndësi për komunën.

Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Izet Zenuni, falënderoi pjesëmarrësit për prezencën dhe paraqiti dy çështje me rëndësi për sigurinë dhe infrastrukturën publike, respektivisht vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit, si dhe funksionalizimin e sistemit të kamerave të sigurisë në qytet.

Më pas, përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, z. Adem Çeku, prezantoi raportin mbi gjendjen e sigurisë në territorin e komunës. Sipas raportimit, gjatë periudhës raportuese janë evidentuar gjithsej 57 raste, kryesisht të natyrës së kundërvajtjeve dhe aksidenteve në komunikacion, si dhe raste të dhunës në familje dhe vjedhjeve. Ai gjithashtu bëri të ditur se Policia e Kosovës ka shtuar masat e sigurisë në institucionet arsimore dhe në trafikun rrugor.

Pas diskutimeve të zhvilluara, anëtarët e KKSB-së vlerësuan se gjendja e sigurisë në Komunën e Deçanit vazhdon të jetë e mirë, e qetë dhe stabile.

Mbledhja përfundoi me konstatimin se bashkëpunimi ndërinstitucional do të vazhdojë me qëllim të ruajtjes së sigurisë publike dhe adresimit me kohë të çështjeve që lidhen me sigurinë në bashkësi.

